

№ 91 / 2001.
data 24/01/18

KONTRATË SHITJEJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT

Sot më datë 22 Janar 2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), ditën e hënë, jashtë selisë së Shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., të ndodhur në adresën: Fier Ballsh MALLAKASTER POCEM, prej dhe midis palëve të mëposhtme:

SHITËSI : **Z. Gazmir Lila**, atësia Asqeri, datëlindja 05 Prill 1984, vendlindja Syzes, Berat, shtetas shqiptar, banues në adresën: Syze, Berat, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit Letërnjoftim me numër personal I40405001L, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "**Pala SHITËSE**".

BLERËSI : **Z. Pajtim Lila**, atësia Asqeri, datëlindja 12 Gusht 1986, vendlindja Syzes, Berat, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga "Rrapo Hekali", pallati Real Konstruksion, shkalla nr.1, apartamenti nr.17, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit Letërnjoftim me numër personal I60812001O, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "**Pala BLERËSE**".

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë KONTRATË SHITJEJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT, sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE

Shoqëria "FONTE FONTANA" Shpk, person juridik shqiptar, regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr.22773 datë 27. 01. 2000, me seli në adresën: Fier, Ballsh, Pocem, Mallakastër, Shqipëri, me NUIS K17710810N, me kapital themeltar të shoqërisë në shumën 48.800.000,00 (dyzet e tetë milion e tetëqind mijë) Lekë dhe ortakë të shoqërisë Z. Ylli Aliaj, i cili zotëron 67% (gjashtëdhjetë e shtatë përqind) të kapitalit të shoqërisë, Z. Adrian Dulaku, i cili zotëron 18% (tetëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë dhe Z. Gazmir Lila, i cili zotëron 15%(pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë. Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria "FONTE FONTANA" Shpk drejtohet prej Administratores së Shoqërisë Znj. Edlira Varfi.

Ortaku Z. Gazmir Lila, kërkon të transferojnë një pjesë të kuotave të Shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., jashtë shoqërisë dhe ortakët shoqërisë dhe janë plotësisht dakord duke i lejuar atij që t'i shesë ato tek të tretët, sipas kushteve dhe kërkesave të parashkruara në këtë kontratë.

Ortakët e shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të datës 22.01.2018, kanë vendosur lejimin e transferimit të kuotave të zotëruara nga ortaku Z. Gazmir Lila, nëpërmjet shitjes së 15%(pesëmbëdhjetë përqind) të pjesëve të zotëruara prej tij, në kapitalin e Shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., pjesë këto tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi në favor të të ortakëve brenda shoqërisë, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to, për blerjen e së cilave ka shprehur interes zotit Pajtim Lila.



Meqë ekzistojnë kushte paraprake, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, palët, me aftësi të plotë për të vepruar dhe me vullnet të lirë, pranojnë të lidhin këtë kontratë për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit të shoqërisë (këtej e tutje si "Kontrata"), sipas kushteve të mëposhtme:

NENI - 1 - OBJEKTI

Me anë të kësaj kontrate, pala Shitëse ortaku Z. Gazmir Asqeri Lila, i cili zotëron 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit shoqërisë, me vlerën prej 7'320.000,00 (shtatë milion e treqind e njëzet mijë) Lekë, në kapitalin e shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., me dëshirën dhe kërkesën e tij i shet dhe i transferon brenda shoqërisë tek pala blerëse zoti Pajtim Asqeri Lila, i cili pranon dhe ble 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit, me vlerën prej 7'320.000,00 (shtatë milion e treqind e njëzet mijë) Lekë, në kapitalin e shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., pjesë tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi në favor të të tretëve, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to.

NENI - 2 - ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGIMIT

Pjesët prej 15%(pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., të zotëruara prej Shitësit, shiten (transferohen) tek Blerësi, i cili pranon t'i blejë kundrejt çmimit në vlerën totale prej 7'320.000,00 (shtatë milion e treqind e njëzet mijë) Lekë, si çmim i vetëm përfundimtar dhe i pandryshueshëm.

Në marrëveshje të përbashkët, palët bien dakord dhe vendosin që Blerësi të kryerjë likuidimin total të çmimit të shitjes në shumën prej 7'320.000,00 (shtatë milion e treqind e njëzet mijë) Lekë, pas nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotave, brenda një afati 5 (pesë) vjeçar, nëpërmjet derdhjeve bankare, që do të kryhen në llogarinë rrjedhëse të përcaktuar dhe të treguar nga pala shitëse zoti Gazmir Lila.

Palët kontraktore në marrëveshje të përbashkët bien dakord, që dokumenti i vetëm zyrtar, i cili vërteton shlyerjen e çmimit, të parashikuar në këtë nen, do të jetë dokumenti bankar (konferma bankare), në favor të Shitësit. Në ekzekutim të kësaj kontrate një kopje e faturës Bankare do t'i bashkangjitet kontratës.

NENI - 3 - KALIMI I PRONËSISË

Që nga momenti i nënshkrimit të kontratës për transferimin e 15%(pesëmbëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, raporti i pronësisë në kapitalin e Shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k, do të jetë si më poshtë :

1. **Z. Ylli Aliaj**, i cili do të zotërojë 67% (gjashtëdhjetë e shtatë përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë;
2. **Z. Adrian Dulaku**, i cili do të zotërojë 18% (tetëmbëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë;
3. **Z. Pajtim Lila**, i cili do të zotërojë 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë;

të cilët të tre së bashku do të jenë bashkëortakë të vetëm në 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k..

NENI - 4 - GARANCITË

Shitësi garanton Blerësin, se kuotat objekt kontrate, nuk janë objekt pengu dhe janë të lira nga çdo lloj titulli e natyre të të tretëve.



Shitësi garanton Blerësin, për gjendjen kontabile të Shoqërisë "FONTE FONTANA" Sh.p.k., sipas aktit të rakordimit të miratuar ndërmjet tyre dhe për këtë deklaron se do të marrë përsipër të shlyejë personalisht çdo detyrim, borxh dhe /ose pasiv që do të rezultojë për të shkuarën, të tashmen apo në të ardhmen duke e liruar plotësisht blerësat nga detyrimet e rezultuara nga aktiviteti i shoqërisë përpara datës së nënshkrimit të kontratës.

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme, individualisht për secilin prej blerëse lidhur me të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër kundrejt palës shitëse dhe anansjelltat. Mosrespektimi i kushteve të drejtave dhe detyrimeve të prej njërit prej tyre, nuk përbën kusht për zgjidhjen e kësaj kontrate nga pala tjetër, dhe do të vazhdojë të prodhojë efektet juridike të saj, në përputhje me të gjitha të gjitha të drejtat dhe detyrimet për secilin prej tyre.

NENI - 5 - BAZA LIGJORE

Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar. Për çdo mosmarrëveshje, që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose ekzekutimin e kësaj kontrate, versioni shqip do të jetë i vetmi version me efekt juridik provues për palët.

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu si dhe për trashëgimtarët e tyre.

NENI - 6 - SHPENZIMET DHE TAKSAT

Shpenzimet legale dhe kontabile ashtu si edhe çfarëdo shpenzimi tjetër që lidhet me këtë kontratë, janë në ngarkim të të dyja palëve.

NENI - 7 - HARTIMI I KONTRATËS

Kontrata përbëhet nga 3 (tre) fletë dhe hartohet në 4 (katër) kopje, kopje të barasvlerëshme në gjuhën shqipe. Çdo njëra prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila palë do të mbajë një kopje. Kopja e katërt depozitohet për regjistrim në zyrën e QKB-së.

NENI - 8 - HYRJA NË FUQI DHE NËNSHKRIMI I KONTRATËS

Detyrimet dhe të drejtat, që burojnë nga kjo Kontratë, fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Palët pasi e lexuan me zë tekstin e kësaj kontrate dhe e gjetën përmbajtjen e saj, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

Z. Gazmir Lila

BLERËSI

Z. Pajtim Lila